

Fatjon LALAJ

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

PËRPUNIMI I LËNDËS ARKIVORE, RËNDËSIA E SAJ DHE ARKIVISTI

***Përmbledhje:** Në Konferencën IV Ndërkombëtare të Arkivistikës do të paraqesim një punim tipik të punës arkivore, i fokusuar te rëndësia e përpunimit të lëndës arkivore. Ky punim merr shkas nga problematikat e hasura nga puna disavjeçare në Arkivin Qendror të Shtetit. Jo rrallëherë ndodh që të konsultosh një dosje arkivore për qëllime pune apo studimore, aty vëren se titulli i dosjes nuk përputhet me materialin e ruajtur brenda saj. Pikërisht përgjegjësia profesionale dhe njerëzore do të jenë në qendër të punimit, duke e vendosur theksin në statusin që të jep titulli arkivist. Punimi do të jetë i fokusuar në anën metodike të arkivistikës si dhe do të t'i japë përgjigje pyetjes pse është i rëndësishëm përpunimi i saktë dhe profesional i dokumenteve arkivore dhe pasojat negative që sjellin ato në informim. Punimi do të jetë i mbështetur në literaturë të teorive arkivore si dhe në përvojën personale të punës.*

Fjalë kyçe: *Punë arkivore, puna me dokumente, njësi ruajtjeje, metodë arkivistike, arkiv*

Në çdo literaturë arkivore lexon përkufizime nga më të larmishmet rreth arkivave dhe rëndësisë së tyre në shoqërinë njerëzore. Diku i gjen të përkufizuara si kujtesë e njerëzimit, diku tjetër si tempull i së vërtetës, diku si dëshmi e historisë kombëtare apo si thesare të vyera të saj. Në këtë punim modest do të përpiqemi të shpjegojmë se përse është shumë i rëndësishëm përpunimi profesional i dokumenteve arkivore dhe roli thelbësor i arkivistit në këtë proces.

Dokumentet janë objekte informacioni që shërbejnë si dëshmi të ngjarjeve të kaluara.¹ Ato shërbejnë si një kujtesë personale apo kolektive të cilat përdoren në të ardhmen, për t'i kuptuar dimensionet e ngjarjeve të shkuara. Dokumentet arkivore i shërbejnë shoqërisë si burime parësore për të vërtetën historike, duke i dhënë asaj një identitet themelor për të kuptuar se nga ka ardhur dhe ku po shkon. Krijuese e arkivave dhe dokumenteve është vetë shoqëria e cila nëpërmjet tyre pasqyron veprimtarinë sociale, historike dhe

¹ Schellenberg T. R., *Modern Archives, principles and techniques*, 1956, f. 15.

atë kulturore.² Ky është një proces i natyrshëm dhe i vazhdueshëm për shkak edhe të vet natyrës të shoqërisë njerëzore e cila është përherë në evolucion. Dokumentet arkivore pasqyrojnë të gjitha fushat dhe sferat e mundshme të shoqërisë, duke i kthyer ato në një kapital të paçmueshëm kombëtar.

Pra, pa u zgatur më tepër rreth rëndësisë së arkivave dhe dokumenteve që ato ruajnë, mund ta kuptojmë rolin më sublim që ato luajnë në jetën tonë. Por, ky është një fenomen të cilin nuk e kuptojmë deri kur çdokujt i është dashur që dokumentin arkivor ta përdorë në dobi të interesave personale apo atyre institucionale.³ Lavdinë e pakontestueshme arkivave ua japin dokumentet të cilat ruajnë. Ky status i vesh një barrë të rëndë këtyre institucioneve në raport me publikun sepse, në fund të fundit, arkivat janë në shërbim të publikut, në funksionin më natyral të tyre. Por kjo është vetëm pjesa e dukshme e një arkivi sepse pjesa e padukshme janë arkivistët të cilët punojnë nëpër arkiva, ku së bashku me dokumentet janë pjesë e lavdisë së këtyre institucioneve. Arkivisti, dokumentet, arkivi përbëjnë një trinom të pandashëm nga njëri-tjetri ku në thelb të tyre qëndron puna me dokumente. Puna me dokumente është një detyrë dhe përgjegjësi për arkivistin.

“Arkivist” është një status të cilin ta jep vetëm një institucion arkivor pavarësisht formimit universitar apo titullit të diplomës që zotëron. Është një status fisnik të cilin individit duhet ta përdorë me përgjegjshmëri njerëzore në radhë të parë dhe profesionale në radhë të dytë. Është e pamundur që në një arkiv të caktuar puna me dokumente e arkivistit të jetë e kontrolluar për cilësinë e saj nga eprorët e tij. Sidomos kur në arkiv dokumentet e pasistemuara dhe të trashëguara si të tilla janë voluminoze dhe puna për sistemimin e tyre sipas kriterëve arkivore kërkon kohë të gjatë. Roli i arkivistit në këtë proces është më shumë se i vyer, për të kuptuar se në duart dhe intelektin e tij ndodhet gjithë ajo lavdi, gjithë ajo pasuri e përmendur më sipër. Puna me dokumente kërkon një ndërgjegje të lartë profesionale, për të mos çuar në një zinxhir të gjatë gabimesh në trajtimin dhe evidentimin e lëndës arkivore në çfarëdo lloj suporti qoftë ajo.

Hilary Jenkison, një nga arkivistët më në zë të shekullit XX në Britani, do ta përkufizonte arkivistin si përkushtuesin më vetëmohues të së vërtetës që prodhon bota moderne, me qëllim që të sigurojë pa paragjykitime për të gjithë ata që duan t'i njohin mjetet e diturisë. Një profesion të besimit, një profesionist që nuk bën kompromis në detyrën e tij.⁴

Arkivistët ruajnë integritetin e arkivave, sigurojnë besueshmërinë e tyre, si një dëshmi e së kaluarës së gjatë, e cila meriton besim, duke qenë objektiv dhe të paanshëm. Arkivistët ruajnë vërtetësinë e dokumenteve gjatë përpunimit, ruajtjes dhe shfrytëzimit, duke zbatuar parimet unike të

² D. Luciana, *Diplomatics*, New Uses for an Old Science, 1998, f. 66.

³ D. P. A, *Manual Arkivor*, f. 31.

⁴ Hilary Jenkison, *A manual of archive administration* (Humphries, 1937).

arkivistikës. Puna arkivore është veprimtari subjektive, por e mbështetur në parime shkencore objektive. Arkivisti jo vetëm që nuk mund të ndërhyjë në origjinalitetin e dokumenteve, por dhe nuk mund t'i prishë lidhjet natyrore të tyre.⁵

Çdokush që hulumton nëpër arkiva ka provuar të paktën njëherë zhgënjimin kur ka vërejtur se dosja arkivore e porositur nuk përmbante në brendësi të saj informacionin që përcillte titulli përshkrues i kapakut. Pra, titulli i dosjes ose ka qenë tepër ilustrues në raport me dokumentet që ajo përmbante ose, në rastin më të keq, nuk arrinte të përshkruante gjithë dokumentet e brendësisë së saj. Praktikisht një dokument i paevidentuar në titullin e dosjes është një dokument i “vdekur” dhe i gjithi ky proces është pjesë e arkivistit.

Titulli i dosjes arkivore është produkti final i një procesi që ka vijuar hallk pas hallke që nga ndërtimi i saj. Ky proces është shumë i rëndësishëm i cili duhet të përmbledhë dhe ta pasqyrojë gjithë veprimtarinë që përmbajnë dokumentet e saj. Ai duhet të jetë i përpiktë, i qartë, i ndërtuar në bazë të rregullave të drejtshkrimit.⁶ Në këtë proces arkivisti duhet të jetë i kujdesshëm, i kuptueshëm dhe bindës duke ruajtur veçoritë historike që përmbajnë dokumentet, sepse kjo është pjesa e cila e përball atë dhe institucionin me publikun. Është pjesa e cila i shton ose i cenon besueshmërinë një arkivi. Kohët e fundit, për shkak të vet zhvillimeve ekonomike dhe sociale që po kalon shoqëria jonë, ka një vëmendje të shtuar ndaj arkivave dhe dokumenteve të tyre, fenomen i cili për ditë e më shumë po i vendos këto institucione para një përgjegjësie të lartë morale dhe profesionale.

Sigurisht që si çdo profesion tjetër, edhe ai i arkivistit ndikohet në masë të gjerë nga formimi dhe shkollimi që zhvillohet rreth disiplinës së arkivistikës. Kërkesat e shoqërisë ndaj profesionit të arkivistit ndryshojnë, duke bërë që edhe identiteti profesional i arkivistëve të ndryshojë vazhdimisht. Ky proces, vetvetiu, kërkon që edhe kurrikulat arsimore të disiplinës shkencore të arkivistikës të jenë në hapin e kohës.⁷ Nevoja e kësaj shkence për hulumtime gjithëpërfshirëse dhe karakteri i saj shkencor është vazhdimisht objekt debatesh.

Trajnimet arkivore dhe specializimet e arkivistëve duhet të jenë të shpeshta dhe të zgjatura në kohë, në mënyrë që ata të familjarizohen me termat dhe të ushtrohen në punë praktike. Një rol të rëndësishëm në institucionet arkivore zë edhe organizimi i punës dhe mbarëvajtja e saj sipas normave teknike të përcaktuara, të cilat hera herës e vendosin arkivistin në një trysni administrative. Në disa procese të përpunimit të lëndës arkivore këto norma duhen të jenë më të zbatueshme, më konkrete, duke mos i vënë arkivistët në

⁵ Kodi Deontologjik i Arkivistëve, Pekin, 2006.

⁶ Mihallaq Pela, *Praktika Arkivore në Shqipëri*, Tiranë, 2003, f. 53.

⁷ D.P.A, *Manual arkivor*, Tiranë, 2008, f. 161.

garë se cili prej tyre do ta bëjë punën më keq, thjesht e vetëm për t'i realizuar ato dhe për të shpëtuar nga penaltetet. Normat teknike duhet të jenë të zbatueshme, deri në nivelin ku në fund të jetë i rëndësishëm cilësia e punës dhe jo thjesht zbatimi i tyre.

Bibliografi:

- Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, *Manual Arkivor*, Tiranë, 2008
Duranti, Luciana. *Diplomatics, New Uses for an Old Science*, Scarecrow Press, 1998
Jenkinson, Hilary. *A manual of archive administration*, Humphries, 1937
Kodi Deotologjik i Arkivistëve, Pekin, 2006
Pela, Mihallaq. *Praktika Arkivore në Shqipëri*, Tiranë, 2003
Schellenberg, T. R. *Modern Archives, principles and techniques*, 1956